



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:060113

Datë: 26.08.2024

Numri i dokumentit: 06083761

P.nr.128/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami, në çështjen penale ndaj të pandehurit S. K. nga fsh. S. K. L., të cilin e akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1740/23 të dt.06.03.2023, për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale të bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 23.08.2024, në prani të prokurorit të shtetit Avni Namani dhe të pandehurit, në të njejtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

S. K., nga babai I. dhe nëna S., e gjinisë O., i lindur me datën ... në fshatin S. në L., ku edhe banon në rrugën "S. H.", i pa martuar, i punësuar në biznesin "T. S.", ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal .., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 11.02.2023 rreth orës 21:35, në lokalin "T. S." në fshatin S. në L., i pandehuri S. K. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, ka organizuar dhe mundësuar bixhozin e lojërave të fatit "B." përmes Laptopit HP me numër serik ..., pa pasur leje nga organi kompetent, çka me këtë ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme,

-me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Organizimi i skemave piramidale të bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69 dhe nenit 294 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon:

DENIM ME BURGIM

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe konform nenit 44 të KPRK-së i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1200-€ (njëmijedyqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20-€.

DETYROHET i pandehuri që kësaj gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të ia paguaj shumën prej 30-€ dhe shumën prej 20-€, në Fondin e Viktimave të krimin,

këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

KONFISKOHET Laptopi HP me nr. serik ..., një printer me numer ser. ..., Tetë cope rolne të letrës për printer, Kabllo ndihmëse për printer, Dy tiketa te lojes bingo me numra ... dhe ... dhe 40-€ para të gatshme të cilat janë sekuestruar të pandehurit nga ana e Policisë së Kosovës, dhe detyrohet policia që sendet e sekuestruara të ia dorëzoj Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar dhe e njejta autorizohet që ta shesë, likujdojë ose ta mbaj pasurinë e specifikuar më lartë, në pajtim me Ligjin për Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1740/23 të dt.06.03.2023, e ka akuzuar të pandehurin S. K. nga fsh.S. K.L., për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale të bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par.2 të KPRK-së.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajsinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe njëherit ka shtuar se është penduar për veprën penale të kryer, është mbajtës i familjes, gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do ta përsërisë këtë vepër dhe ka shtuar se këtë aktivitet e ka ushtruar vetëm me një laptop të cilin i'a kanë konfiskuar policia, gjykatën e ka lutur të i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shteti në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës si dhe bazë ligjore në dispozitat e KPPK-së si dhe i ka propozuar gjykatës që ta merr pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese pasi që i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar asnjëherë.

Mbrojtësja e të pandehurit në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se i pandehuri e pranon fajësinë me vetëdije të plotë pasi që e ka kuptuar se kjo veprimtari ka qenë e ndaluar ligjërisht andaj e ka lutur gjykatën që t'i pranoj si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë dhe premtimin e tij se i njejti nuk do të kryej vepra të tilla dhe faktin se asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, i njejti është person familjar andaj e ka lutur gjykatën që t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësen e tij, pranimi i fajësisë nuk është rezultat i përdorimit të forcës, dhunës dhe premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konform nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është mbajtës i familjes dhe ka një fëmijë dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit me gjobë konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, për paushall gjyqësor shuma prej 30-€, ndërsa shuma prej 20-€, u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për konfiskimin u bazua në nenin 269 të KPPRK-së, pasi që sendet e konfisukara janë sende me te cilat është kryer vepra penale.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN

P.nr.128/23 dt.23.08.2024

Bashkëpunëtorja profesionale

Vesa Bajrami

GJYQTARI

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate